



Pranuar / Dorezuar Punijeno/Prodato Received/Delivery	28.12.2023	3	viti god year
Organ / Njësia Org./Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	7719/2023		1/2



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1420/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, anwtarw, me Sabile Avdyli, -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, duke vepruar sipas ankesës më numër A.nr.1420/2023, të datës 16.11.2023, të parashtruar nga ankuesi në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 si dhe neni 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.12.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1420/2023, të datës 16.11.2023, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 16.11.2023, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e regjistruar nën shenjen A.nr.1420/2023, kundër ndalimit të pagës për muajin gusht 2023 dhe lirimit nga pozita e zëvendës Kryetarit për Komunitete në Komunën e Zveçanit pa vendim, ndërsa, i njëjti më datë 28.12.2023, përmes shkresës me numër protokollit 7690//2023, për arsye personale është tërhequr nga ankesa A.nr.1420/2023 e datës 16.12.2023.

Kolegji i Këshillit duke marrë për bazë kërkesën e datës 28.12.2023 të ankuesit për tërheqje nga ankesës A.nr.1420/2023, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: "Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë", dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1420/2023 të datës 16.11.2023, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.1420/2023

Sabile Avdyli

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Ardita Haxhnikaj-Demi
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Zveçanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

